

LYPSET SHUMË KOHË QË TË BASHKOHEN REALITETET

Çaste me albanologun Robert Elsi,
pjesëmarrës në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare

Albanologu, Robert Elsi (Elsie) u lind në Vankuver (Vancouver) të Kanadasë më 1950. Ndoqi Universitetin e Kolumbisë Britanike, ku mbaroi studimet e filologjisë klasike dhe të gjuhësisë. Erdhi në Evropë me një bursë studimesh, vazhdoi studimet e larta në Universitetin e Lirë të Berlinit Perëndimor, në Shkollën Praktike të Studimeve të Larta në Paris, në Institutin e Dublinit, pastaj në Universitetin e Bonit, në Gjermani, ku edhe u doktorua më 1978. Në fushën e albanologjisë, përveç reçensave dhe artikujve të ndryshëm, ka botuar disa vepra të rëndësishme, në anglisht dhe gjermanisht. Disa vite me radhë mori pjesë aktive në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, ku po qëndron edhe këto dite.

Në pyetjen se a u ruajt karakteri kompleks i veprimtarisë së seminarit, zoti Elsi thotë se "ndryshimi rrënjësor më duket është fakti që sivjet kanë ardhur relativisht pak njerëz. Kuptohet, është hera e parë pas çlirimit të Kosovës që seminari zhvillohet pas një ndërprerjeje shumë të gjatë, për arsye të ndryshme. Megjithatë, më duket se e ruajti karakterin e tij, pra është po ai që ka qenë."

TRI UDHETIMET E EVLIJA ÇELEBISË

Gjatë këtij seminari u promovua edhe vepra e albanologut Elsi "Evliaja Çelebija në Shqipëri dhe në viset përreth, Kosovë, Mal të Zi dhe Ohër", botuar në gjuhën angleze. Autorin e lutem që të na flasë më shumë për këtë vepër.

"Evliaja Çelebija, siç dihet, ishte një udhëtar turk i shek. XVII i cili udhëtoi në gjithë botën, duke hartuar disa vëllime të udhëpërshkrimeve të tij. Ndër to është një material shumë i pasur për Shqipërinë. Ai kishte bërë tri udhëtime në Shqipëri: njëherë në Shqipërinë e Jugut (që nga Delvina deri në Elbasan); herën e dytë në Shqipërinë e Veriut (duke udhëtuar nëpër Shkodër, Ulqin e Kotor), dhe një herë ishte në Kosovë. Këto tri udhëtime janë përshkruar prej tij me shumë materiale për zakonet, veshjet, ushqimin, për gjuhën, monumentet e kulturës, kryesisht për kulturën islame. Kjo pjesë e shkrimeve për udhëpërshkrimet e tij u përkthye shqip në vitet 1930-1931 nga Sali Vuçitërna, por përkthimi kishte mjaft lëshime dhe nuk e pasqyrore realitetin e dorëshkrimit. Unë kam punuar në këtë vepër me turkologun shumë të njohur nga Universiteti i Çikagos, Robert Dankof, i cili e ka transliteruar dorëshkrimin nga osmanishtja, kurse unë e përktheva nga osmanishtja dhe turqishtja në anglisht. Tash kemi të bëjmë me dorëshkrimin e mirëfilltë dhe me një përkthim të besueshëm. Teksti është botuar paralelisht turqisht dhe anglisht. Kemi futur edhe dorëshkrimin origjinal me shkronjat arabe, ka dhe një hyrje dhe disa fotografi. Ka një informacion shumë të pasur për Shqipërinë e asaj kohe."

KA NJE UNITET KOMBËTAR DHE KA ENDE DY REALITETE

Veprën t tij "Një fund dhe një fillim / Vëzhgime mbi letërsinë dhe kulturën shqiptare" (botoi "Buzuku" i Prishtinës) Robert Elsi e përfundon me vështrimin "Një kulturë - dy realitete. Rëndësia e letërsisë kosovare në Shqipëri". E pyetëm se a ka ndryshuar diçka, në

ndërkohë, në këto raporte.

”Shumë gjëra kanë ndryshuar,” thotë Elsi, ”por në fund gati se asgjë nuk ka ndryshuar. Është e qartë se vetëm kur shqiptarët bashkohen në fushën kulturore, mund të thuhet se ka një bashkim. Shqiptarët njohën njëri-tjetrin tashti për herë të parë në këtë shekull. Ardhja e gjysmë milioni kosovarësh në Shqipëri ishte njohje e parë për shumë njerëz. Kufiri u hap dhe të dy vëllezërit janë të lirë tani, kështu që nuk ka pengesë politike e ushtarake siç ka pasur përpara. Ka një unitet kombëtar dhe ka akoma dy realitete. Besoj që është e qartë për çdo njeri se ka një realitet kosovar, një kulturë kosovare, një jetë kosovare dhe, në anën tjetër, një realitet, një kulturë, një jetë tjetër në Shqipëri. Unë mendoj se lypset shumë kohë që të bashkohen realitetet. Edhe në fushën e kulturës ka shumë e shumë për t’u bërë. Por unë nuk jam prej atyre që duan detyrimisht një ribashkim me zor të vlerave. Unë mendoj se variacionet janë një pasuri e kulturës shqiptare. Mendoj se është gjë e bukur që kultura kosovare të zhvillohet në një drejtim, kurse kultura e Shqipërisë në një drejtim tjetër. Bota shqiptare është më pak unike, prandaj edhe shumë më e pasur.”

FJALORI, ”MEMOARET...” E NOPÇËS, DHE ”HISTORIA..” E FAVERIALIT

Në cilat projekte është përqendruar vëmendja e albanologut Elsi kohëve të fundit?

”Sivjet do të botoj një libër, i cili besoj se do të jetë me shumë interes, meqë është fjala për një fjalor të besimit shqiptar, apo të kulturës popullore shqiptare, ku do të përfshihen fusha e fesë, ajo e mitologjisë, zakonet popullore, etj. Ky libër do të botohet në gjuhën angleze në Londër e Nju Jork gjatë tetorit ose nëntorit. Libri ka rreth 300 faqe dhe shpresoj se do të ndihmojë shumë në njohuritë e botës së jashtme për kulturën shqiptare. Kam edhe dy vepra të tjera, të pabotuara. Njëra është ”Memoaret e Baron Franc Nopçës” (Franz Nopcsa). Nopça ishte një albanolog hungarez, i cili vdiq në prill të vitit 1933. Ai la pabotuar memoaret e tij. Kishte kaluar shumë kohë në Shqipërinë e Veriut, në Shkodër kryesisht, para Luftës së Parë Botërore, dhe në Prizren. Memoaret janë jeta e tij, dhe nëse gjej ndonjë shtëpi botuese do t’i botoj në gjermanisht. Ndërkaq vepra tjetër është ”Historia e Shqipërisë”, e para histori e tillë e shkruar ndonjëherë. Autori ishte një prift francez me emrin Zhan-Klod Faverial (Jean-Claude Faveyrial), i cili ka jetuar një kohë të gjatë në Manastir dhe është shquar si mik i madh i shqiptarëve dhe i vllahëve. Ai la ”Historinë e Shqipërisë” të pabotuar frëngjisht. E kam kërkuar këte dorëshkrim pesë vjet me radhë, dhe në mars të këtij viti e gjeta në një arkiv, në Paris. Këtë do ta botoj në gjuhën frënge. Në këtë vepër bëhet fjalë për historinë e Shqipërisë prej kohës së lashtë e deri më 1888. Është një vepër mjaft interesante.”

”... PSE NJË I HUAJ INTERESOHET PËR NJË GJUHË QË S’E KUPTON NJERI”

Si e ndjenit veten dikur në Kosovë, e si e ndjeni tani?

”T’iu them të drejtën, kur erdha për herë të parë isha krejtësisht i pafajshëm për gjërat e Ballkanit. Nuk kisha asnjë drojë, asnjë frikë meqë erdha për të marrë pjesë në Seminar. Pastaj u interesova më shumë, jo vetëm për kulturën, por edhe për politikën, dhe gjatë këtyre viteve kam shoqëruar zhvillimet e politikës, gjithë këtë tatpjetë politike në Kosovë. Gjatë viteve ‘80 erdha me pak drojë, dhe herë pas here kam pasur probleme, bie fjala në Aeroportin e Prishtinës ku Sigurimi Serb më ka mbajtur disa orë dhe më ka marrë në pyetje, meqë kisha bërë një gabim të rëndë, një shkelje flagrante: kisha libra shqip në çantën time. Policisë iu desht të shënonte të gjithë titujt dhe autorët e tyre. Kisha dyzet libra. Më pyesnin se pse një i huaj interesohet për një gjuhë që s’e kupton njeri. Bile njëri më pyeti se çfarë gjuhë është kjo (gjoja

nuk dinte). Mirëpo kjo kohë ka kaluar dhe unë ndihem shumë mirë në Prishtinë, në Kosovën e lirë. Për mua, është një kënaqësi e madhe që shoh, pas kaq shumë vjetësh, që ky vend është i lirë, po aq i lirë sa të gjitha vendet e Evropës.”

Intervistoi: Ali Olloni.

[botuar në gazetën: *Koha ditore*, Prishtinë, 26 gusht 2000, f. 16]